# Drive

PORSCHE
ALBANIA

12/20

# ID.3

## Veri-Jug me një karikim

08 **KAMIQ si ti** *Friens like you*

12 **15 vjet Porsche Albania** *15 years Porsche Albania*

20 **40 vjet quattro** *40 years quattro*

# Përmbajtja

## *Content*


**KAMIQ si ti**
*Friends like you*
08

**Zbulohet "misteri" i makinave të kamufluara**
*The "mystery" of camouflaged cars*
10

**15 Vjet Porsche Albania**
*15 years Porsche Albania*
12

**ID.3**
14

Revista Drive është një botim periodik i Porsche Albania.
Realizimi: Botues Porsche Albania
Realizimi grafik: Source One

Burimi: Audi: Audi-Mediaservice.com
SEAT: media.SEAT.com
Volkswagen Makina Tregtare: volkswagen-media-services.com
Volkswagen Magazine
ŠKODA: press.ŠKODA-auto.com.



Për komente, pyetje apo sugjerime ju lutem na kontaktoni në office@porsche.al ose në numrin e telefonit: +355 (04) 240 74 30.

Porsche Albania,
Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 7, Rr. Monun
Telefon: +355 (04) 240 74 30
Fax.: +355 (04) 240 74 34
e-mail: office@porsche.al; http://www.porsche.al

**Përse një makinë elektrike?**
*The 'whys' of electric cars?*
16

**Kalaja e Tiranës**
*Tirana Castle*
18

**40 Vjet quattro**
*40 years quattro*
20

**Giveaway**
23

**Cupra formentor**
25

**Gentian Bushati**
Drejtor i përgjithshëm Porsche Albania
*General Manager Porsche Albania*

# 15 vite histori!
## Rrugëtimi vazhdon...

Kanë kaluar 15 vite nga momenti i parë që Porsche Albania, pjesë e Porsche Holding, pjesë e familjes së madhe Volkswagen Group, nisi rrugëtimin në tregun automotiv shqiptar si e vetmja kompani ndërkombëtare në treg.

Ishte viti 2005, kur Porsche Albania hyri në treg fillimisht me vetëm dy marka, Seat dhe Audi. Të dyja këto marka vinin për herë të parë zyrtarisht në Shqipëri. Ky moment shënoi gurin e parë kilometrik, për të vazhduar më tej ndër vite me marrjen e eksluzivitetit të markës ŠKODA, Volkswagen makina tregëtare dhe prej vitit 2012 të Volkswagen makina për pasagjerë. 5 marka prestigjoze nën një emër, Porsche Albania.

Në vitin 2013, portofolit të shërbimeve në Porsche Albania iu bashkua me shërbimet e saj financiare, kompania simotër, Porsche Leasing. Një tjetër moment kyç që pozicionoi Porsche Albanian si kompaninë e vetme në Shqipëri që ofron modelin e biznesit "One Stop Shop".

Me mbi 7 milionë euro të investuara deri më sot, ambicja që vjen si rrjedhojë e zhvillimit të tregut dhe kërkesës së konsumatorëve, na bën të rendim më tej drejt pasurimit të portofolit të markave tona në të ardhmen e afërt.

Me rreth 10,000 makina të shitura, mbi 100,000 urdhëra puna dhe më shumë se 32,000 klientë në këto 15 vite me markat Audi, Seat, Volkswagen makina tregtare, Volkswagen makina pasagjerësh si dhe markën Dasweltauto për makinat e përdorura, Porsche Albania është padyshim ndër kompanitë lider në tregun automotiv në Shqipëri.

Një tjetër element shumë i rëndësishëm është investimi në rritjen profesionale të skuadrës tonë. Janë me mijëra orë trajnime për stafin e shitjes dhe servisit, që kanë bërë të mundur një shërbim të shkëlqyer ndaj klientëve dhe partnerëve, duke na diferencuar në treg dhe duke ndikuar në nxitjen e konkurrencës në cilësinë e shërbimit.

Në vitin 2005 nisëm rrugëtimin tonë me një skuadër të vogël prej 12 vetash dhe sot kemi pjesë të ekipit tonë 73 punonjës profesionistë. Një vlerë e padiskutueshme është balancimi gjinor ku 40 % e drejtuesve të departamenteve në kompani janë femra. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është ofrimi i mundësive për praktika të punës për studentë dhe nxënës të shkollave mësimore, gjithashtu dhe punësimi i profesionistëve të rinj të motivuar dhe të fokusuar në kryerjen me profesionalizëm dhe me përgjegjshmëri ligjore dhe shoqërore të detyrave në çdo department.

Këto shifra na bëjnë që të jemi krenar dhe të jemi një nga kompanitë më të sukseshme të tregun automotiv në Shqipëri në këto 15 vite histori!

Sfidat, që këto 15 vite kanë sjellë përballë skuadrës së Porsche Albania, kanë qenë të shumta, por po aq edhe zgjidhjet që janë gjetur, gjë që ka bërë të mundur rritjen e vlerësimeve nga klientët tanë përsa i përket cilësisë së marrjes së shërbimeve si nga sektori i shitjeve ashtu edhe i servisit.

Ndër vite, kemi prezantuar në treg me dhjetra modele të markave tona, shpesh me evente dhe qasje që përbënin risi në tregun automotiv duke sjellë në këtë mënyrë në Shqipëri një frymë ndërkombëtare që shpejt u përqafua edhe nga kompani të tjera në tregun tonë.

Markat ŠKODA dhe Volkswagen makina për pasagjerë, janë të listuara në 3 pozicionet e para në tregun automotiv në Shqipëri. Ndërkohë, Volkswagen makina tregtare vazhdon të udhëheqë në këtë segment të tregut (referuar deri në vitin 2019).

Makinat elektrike dhe hibride, digjitalizimi, kërkesa për oferta të personalizuara, zhvillimi dhe hyrësit e rinj në tregun premium të makinave si dhe ndërgjegjësimi për një ambjent më të pastër, kanë qenë shtysa dhe motivi që Porsche Albania t'u përgjigjet me shpejtësi dhe përgjegjësi të gjithë këtyre ndryshimeve.

Jemi krenarë që Porsche Albania ka prezantuar e para në Shqipëri, në vitin 2016 makinat elektrike me markën Volkswagen e-Golf, si dhe ato hibride siç është Passat GTE. Sot, 4 vite më pas, me rritjen e numrit të makinave elektrike të shitura, Porsche Albania ka dhënë kontributin e saj në reduktimin e CO2 dhe uljen e ndotjes mjedisore si një anagazhim global që na përket të gjithëve.

Digjitalizimi në Porsche Albania ka qenë i hershëm si në aspektin e shitjes dhe atë të pas shitjes. Gjithashtu në rrejtet sociale dhe në faqet tona janë më shumë se 285,000 ndjekës aktiv, një angazhim që na çoi në hapin tjetër të suksesshëm për kompaninë tonë, zhvillimin dhe prezantimin e aplikacionit revolucionar për industrinë automotive në Shqipëri, aplikacioni "Makina Ime". Ky aplikacion sot njeh më shumë se 52,000 shkarkime dhe më shumë se 25,000 të rregjistruar, ky aplikacion është "shoferi juaj në kohë digjitale" dhe për ne në Porsche Albania ka për qëllim të jetë partneri juaj i lëvizshmërisë.

Shembulli që Porsche Albania jep për një konkurencë të ndershme dhe në përputhshmëri me të gjitha normat dhe ligjet në fuqi, jep një garanci më shumë në rritjen e besueshmërisë te klientët tanë, një shëmbull ky që është vlerësuar edhe nga partnerët tanë në biznes.

Viti 2019 u mbyll me ngjarjen tragjike atë të tërmetit në nëntor, ku shumë jetë u humbën tragjikisht, mijëra shtëpi u rrafshuan duke e bërë kështu 26 nëntorin një prej ditëve më të trishta për kombin tonë. Si një kompani e cila i jep rëndësi përgjegjësisë sociale, Porsche Albania u gjend pranë shqipëtarëve edhe në ato ditë të vështira dhe së bashku me kompaninë simotër Porsche Leasing, kontribuam me disa mijëra euro në fondin e rindërtimit të banesave të dëmtuara.

Ndërkohë që ky përvjetor i 15-të i yni erdhi ashtu siç askush nga ne nuk e kish imagjinuar, me një virus të panjohur. Pandemia COVID-19 sprovoi shumë familjen shqiptare si në çdo vend të botës, në mënyrën më ekstreme, atë të kërcënimit të jetëve dhe shëndetit publik. Kjo pandemi solli edhe një sfidë tjetër më shumë në thellimin e vështirësive ekonomike për shumë individë, biznese dhe sektorë ekonomik.

Në një normalitet të ri, të panjohur më parë, Porsche Albania vedosi në fokusin kryesor mirëqenien dhe shëndetin e punonjësve, vlerën më të madhe të kompanisë, si dhe klientët tanë, duke marrë masa organizative dhe logjistike në funksion të këtij qëllimi.

Ja dolem me sukses të ruanim kolegët tanë pavarësisht vështirësive dhe të panjohurës që koha na vendosi përpara. Garantuam vazhdueshmërinë e biznesit duke integruar zgjidhje dhe alternativa bashkëkohore në komunikimin e aktiviteteve tona, optimizuam kostot dhe i qëndruam gjithmonë pranë dhe besnik partnerëve tanë, pa ndërprerë shërbimin dhe duke iu përgjigjur nevojave të klientëve në çdo moment.

Sot, në përvjetorin e 15-të, Porsche Albania i shpreh nderimin më të sinqertë të gjithë klientëve dhe partnerëve të biznesit. Një falenderim shumë i madh shkon për të gjithë skuadrën e Porsche Albania që me mençuri, profesionalizëm dhe sakrificë ka arritur të mbajë në majat më të larta biznesin e kompanisë tonë, Porsche Albania.

Anganzhimi ynë për të ardhmen është të vazhdojmë të jemi inovatorë në ide, veprime dhe në model biznesi, për t'i sjellë partnerëve tanë gjithmonë shërbim sa më të shpejtë e cilësor, mbi baza besimi reciprok, integriteti dhe profesionalizmi gjithnjë e në rritje.
Porsche Albania do të jetë partneri juaj në Lëvizshmëri!

Gjej rastin, t'ju uroj ju dhe familjeve tuaja Gëzuar Festat e fundvitit dhe një vit të ri sa më të mbarë!

# 15 years of history!
# The journey goes on ...

It has been 15 years since Porsche Albania, part of Porsche Holding and Volkswagen Group family, started its journey in the Albanian automotive market as the only international company.

It was 2005 when Porsche Albania entered the market, initially with only two brands: Seat and Audi. Both for the first time in Albania. This moment was the first milestone followed, over the years, by the acquisition of ŠKODA exclusivity, Volkswagen commercial vehicles and, from 2012, Volkswagen passenger cars. 5 prestigious brands under one name - Porsche Albania.

In 2013, the service portfolio in Porsche Albania was enlarged by including, in terms of financial services, its sister company, Porsche Leasing. Another moment that positioned Porsche Albanian as the only company in Albania offering the “One Stop Shop” business model. With over 7 million Euros invested so far, the ambition that comes with market developments and, consumer demand, make us running faster toward enriching our brand portfolio for the near future.

With around 10,000 cars sold, over 100,000 work orders and more than 32,000 customers acquired in these 15 years through the Audi, Seat, Volkswagen commercial vehicles, Volkswagen passenger cars and, Dasweltauto used cars, Porsche Albania is definitely one of the leading companies in the automotive market in Albania.

Another essential component has been investing in the professional growth of our team. We count thousands of hours of training for the sales and services staff, leading to excellent services provided for our customers and partners, which differentiate us in the market and influence the promotion of competition in terms of service quality.

In 2005, we started our journey with a small team of 12 people whereas today, we count 73 professional employees. An indisputable value is the gender balance, with 40% of the company’s heads of departments being females. Another important aspect is the provision of internship opportunities for students of universities and vocational schools, as well as the employment of motivated young professionals, committed to high-level performance and observance of law and social responsibilities, at all departments.

These figures make us proud and one of the most successful companies in the automotive market in Albania in these 15 years of history!

The challenges Porsche Albania team has dealt with these 15 years have been numerous, as were the respective solutions generated, enabling an increase in appreciation from our customers in terms of the quality of services received by the sales’ and services’ sectors.

Over the years, we have introduced dozens of models of our brands to the market, often through events and approaches innovative to the automotive market, thus bringing to Albania an international spirit quickly embraced by other companies in our market.

ŠKODA and Volkswagen passenger cars are listed in the first 3 positions in the Albanian automotive market. In the meanwhile, Volkswagen commercial vehicles continue leading this market segment (as of 2019).

Electric and hybrid cars, digitalization, demand for personalized offers, development and the new entries in the premium car market, as well as awareness on a cleaner environment, have been the impetus and motivation behind Porsche Albania quick and responsible adaptation to all these changes.

We at Porsche Albania are proud to having introduced in 2016, for the first time in Albania, Volkswagen e-Golf electric cars, as well as hybrid ones, such as Passat GTE. Today, 4 years later, through the increase in the number of electric cars sold, Porsche Albania continues contributing to the reduction of CO2 levels and of environmental pollution in general, in the name of the global commitment affecting all of us.

Digitalization at Porsche Albania has been anticipative, both in terms of sales and the aftermath. More than 285,000 persons are active members and followers of our social network and media, a commitment inspiring us to the next successful step: the development and presentation of a revolutionary application for the automotive industry in Albania - “My Car” App. As of today, the application recognizes more than 52,000 downloads and more than 25,000 persons registered. It is “your driver in digital time” and we, at Porsche Albania, wish at becoming your mobility partner.

The model that Porsche Albania is setting for fair competition and pursuant to all norms and laws in force, provides an added guarantee in increasing the credibility toward our customers, a model highly appreciated by our business partners.

2019 ended with the tragic November earthquake, whereby many lives were tragically lost to us and thousands of homes were destroyed, turning November 26 to one of the saddest days for our nation. As a company that attaches great importance to social responsibility, Porsche Albania was close than ever to the Albanians, even in those difficult days and, together with its sister company Porsche Leasing, we contributed with several thousand euros to the fund for the reconstruction of the damaged homes.

This 15th anniversary came, instead, as none of us had ever imagined: brining by an unknown virus. COVID-19 pandemic greatly tested the Albanian households, as in any other country in the world, in the most extreme way, by threatening our lives and public health. This pandemic posed one more challenge: widening the financial hardship for many individuals, businesses and economic sectors.

In this new normality, previously unknown to all of us, Porsche Albania’s greatest wealth, its employees’ and customers’ well-being and health, were in the spotlight, taking organizational and logistical measures in its view.

We managed to successfully keep our colleagues despite the difficulties and the unknown that time put in front of us. We guaranteed business continuity by integrating contemporary solutions and alternatives in the communication of our activities, optimized the costs and always stayed by and loyal to our partners, without discontinuing our services and responding to the needs of our customers anytime.

Today, in its 15th anniversary, Porsche Albania expresses its most sincere reverence to all customers and business partners. A very big thank you goes to the entire Porsche Albania team that with wisdom, professionalism and sacrifice, has managed to keep the business of Porsche Albania at the highest peaks.

Our commitment to the future is moving forward with innovative ideas, activities and our business model, always bringing to our partners the fastest and highest quality services, based on mutual trust, integrity and ever-growing professionalism.
Porsche Albania shall be your partner in Mobility!

I take this opportunity to wish you and your families Happy Holidays a prosperous new year!

# Marketingu: gjatë dhe pas pandemisë

## *Marketing: during and after the pandemic*



Koronavirusi e ka ndryshuar ndjeshëm peisazhin e marketingut, përtej normales. Buxhetet janë ngrirë. Eventet janë anuluar. Sjellja e konsumatorit ka ndryshuar. Ne, tregtarët, mezi po presim që bota të "kthehet në normalitet", por çfarë është normale? Edhe kur konsumatorët të rinisin blerjet, mund të ketë ndryshime rrënjësore në kategoritë e produkteve, segmentimin e tyre dhe pozicionimin e produkteve që do t'i mbijetojnë pandemisë.

Nuk është më sekret që jetojmë në një botë gjithnjë e më digjitale, dhe pandemia COIVID-19 e ka përshpejtuar këtë trend në mënyrë eksponenciale. Përpos kalimit të pjesës më të madhe të kohës në internet dhe në aplikacione, qëndrimet, sjelljet dhe zakonet e blerjes së konsumatorëve në internet kanë ndryshuar tashmë. Një nga sjelljet e reja të blerjes, që është zhvilluar gjatë këtij "normaliteti të ri", është që njerëzit po bëjnë më shumë blerje në internet. Duke qenë se lëvizja ishte e limituar dhe individët e interesuar nuk mund të vinin në sallonet tona për të provuar makinat, ne vendosëm që t'i çonim makinat pikërisht aty ku klientët tanë potencialë ndodheshin: në shtëpi. Fushata e "Test Drive from home" ishte një nga praktikat që ndoqëm.

Me uljen e buxheteve të marketingut, ne na është dashur të ri konceptojmë strategjitë tona të shitjes dhe mbajtjes së klientit. Në këtë periudhë, një reklamë e shtrenjtë në televizion, pa ndonjë ndikim të gjurmuar, nuk është më një opsion. Në vend të kësaj, ne po i drejtohemi kanaleve më pak tradicionale por më të efektshme; siç janë partneritetet, programet e referimit dhe kryesisht projektet argetuese. Keshtu lindi edhe ideja qe modelin e ri te Skoda, i cili quhet Kamiq ta prezantonim nëpërmjet një kënge të dedikuar dhe krijuar enkas për të. Donim të sillnim diçka ndryshe, dhe realizuam njç kënge për makinën në bashkëpunim me ambasadorin e markës, producentin Elgit Doda. Kënga e quajtur "Ka miq si ti" me melodinë verore dhe një tekst kaq afër përditshmërisë tonë, i dha ngjyra markës Skoda. Po kaq kreative ishte dhe prezantimi i Skoda Octavia në misionin kamouflazh. Dy makina u veshën me letër kamouflazh 360 gradë dhe dolën nëpër qytetet më të mëdha të vendit në një mision undercover. Javën e fundit kryen test drive-e duke pyetur të interesuarit se cila do të ishte kjo makinë, dhe vetëm besnikët e markës Skoda mundën ta dallonin. Kjo krijoji shumë zhurmë si në kanalet online por edhe në rrugët ku kalononin makinat duke rrëmbyer vëmendjen e audincës në të gjitha format.

Gjatë kohës së karantinës, duke ditur që ndjekësit kishin më shumë kohë në duar, vumë re se markat tona kishin një audiencë më të lartë. Mediat tona sociale janë ndjekur në këtë periudhë nga më shumë njerëz se kurrë.

Ky ishte treguesi i parë i cili na shtyu që të mos i pezullojmë prezantimet e modeleve të reja nga markat tona. Përkundrazi, po përshtateshim duke praktikuar prezantime online, live të makinave të reja, dhe kjo për ne është bërë tashmë krejt normale. Deri më tani, kemi prezantuar në këtë format dy makina tepër të rëndësishme për ne, Audi S8 dhe Volkswagen ID.3. Kjo formë digjitale prezantimi, e cila u aplikua për herë të parë në vend nga Porsche Albania, rezultoi të kishte një audience live 80% më të lartë se një event tradicional. Kjo risi në treg erdhi në emër të digjitalizimit dhe sigurisë së njëri-tjetrit.

Duke marrë parasysh ndikimin ekonomik të kësaj krize dhe faktin që nuk e dimë se çfarë do të sjellë e ardhmja, ne vendosem të ri konceptojmë strategjinë tonë afatgjatë. Dhe në strategjinë tonë të re të marketingut, gjatë dhe pas pandemisë, do të përqendrohemi në përdorimin e përmbajtjeve që krijojnë lidhje të fuqishme përmes internetit duke e humanizuar markën.

Gati çdo reklamë këto kohë fillon me një hyrje të zakonshme me muzikë të lehtë dhe të pasuar me fraza si "në këto kohë të pa precedent" apo "ne jemi këtu për ty", pra me pakëz ndryshim nga njëra tjetra, por të gjitha mbeten njësoj. Njerëzit janë lodhur me to. Kështu, ne, kemi vendosur që të dalim në mediat sociale dhe te flasim hapur dhe me sinqeritet me audiencën tonë. Sa më shpejt të përqafojmë realitetin e që po përjeton audienca jonë, aq më të suksesshëm do të jemi në përgjithësi, veçanërisht në mediat sociale.

Ne po ndërtojmë audienca besnike dhe si për çdo markë, kjo besnikëri do të paguajë në terma afatgjatë. Një shembull që do të donim ta ndanim me ju është Giveaway i 15 vjetorit. Për të festuar këtë përvjetor Porsche Albania dhuroi një Skoda Fabia nëpërmjet një shorteu i cili u mbajt në datën 15 dhjetor. Fituesi u zgjodh nga audienca e aplikacionit "Makina Ime" i cili prej 2 vitesh është një nga projektet më të rëndësishme të kompanise tonë. Kjo mënyrë shpërblimi bëri që një nga 26,000 përdoruesit e aplikacionit të fitonte këtë makinë.

Ndërsa askush nuk e di se si do të duken konturet e sakta të normales tjetër, një gjë është e sigurt: konsumatorët do t'i kthehen tregut. Mund të ndodhë po aq shpejt sa ndodhi edhe karantina. Kjo është arsyeja pse për ne është kritike që ta mbajmë marketingun të gjallë në këtë moment – duke qenë të gatshëm të takohemi me konsumatorët në çdo formë apo moment.

The coronavirus has significantly changed the marketing landscape beyond recognition. Budgets are frozen. Events are cancelled. Consumer behavior has changed. Us, marketers are anxiously awaiting the world to “return to normal,” but what does normal look like? Even when consumers start buying again, there may be radical changes in product categories, segmentation, and product positioning that will outlast the pandemic.

It’s no secret that we live in an increasingly digital world, but the COIVID-19 pandemic has accelerated this trend exponentially. In addition to spending more time online and in apps, consumers’ online attitudes, behaviors, and purchasing habits have already changed. One of the new buying behaviors that has developed during this “new normal” is that people are buying more online. Since movement was limited and interested individuals could not come to our showrooms to test our cars, we decided to bring the cars to them, where they were: at home. The “Test Drive from Home” campaign was one of the practices we applied.

With the slashing of marketing budgets, we have needed to redesign our sales and customer retention strategies. During these times a pricey TV commercial without any traceable effect is not anymore, an option. Instead, we are switching to less traditional but more effective channels such as partnerships, referral programs and entertaining projects. That is how the idea to launch the new Skoda Kamiq through a dedicated song created specifically for it, came to life. We wanted a different approach and produced a song for the car with the brand ambassador, the producer Elgit Doda. The song titled “Friends like you” with a summer beat and text so much alike our every day’s routine made the Skoda brand more colorful. The same creativity drove the presentation of Skoda Octavia in its camouflage mission. Two cars wrapped with camouflage all around drove the biggest cities of the country in an undercover mission. During the last week’s test drives the interested drivers were asked to find out what the test drive car was and only the Skoda brand loyal customers were able to find out. This created a wave of discussions in online channels and on the streets too grabbing the attention of the audience in all forms

During the quarantine, we noticed that our brands were receiving greater audiences as followers had more time to engage. Our social media have had the highest followers ever during this period.

This was the first indicator that encouraged us not to suspend the launch of new models of our brands. On the contrary, we were adapting by making online presentations, live launches and this has become quite normal for us now. We have, so far introduced in this format two very important cars for us, Audi S8 and Volkswagen ID.3. This digital form of introduction, which was first applied in the country from Porsche Albania, turned out to have a live audience 80% higher than a traditional event. This innovation in the market came in the name of digitalization and keeping each other safe.

Considering the economic impact of this crisis— and the fact that we don’t know what the future will bring, we decided to redesign our long-term strategy. In our new marketing strategies — during and after the pandemic — we will focus on using content that creates powerful online connections by humanizing our brand.

Almost all of the TV commercials right now have a generic intro of soft music followed by phrases such as "in these unprecedented times" and "we're here for you", slightly varying but yet remaining all the same. People are over it. That is why we have decided to communicating through social media talking openly and honestly with our audience. The faster we embrace the reality of what our audience is experiencing the more success we’ll be overall, especially on social media.

We are building loyal audiences and that loyalty will pay off long-term. An example we would like to share with you is the 15th Anniversary Giveaway. To celebrate this anniversary Porsche Albania gave away a Skoda Fabia through a lottery draw which was held on December 15th. The winner was chosen by the audience of the application "My Car" which has been one of the most important projects of our company for the last two years. This way of rewarding enabled one of the 26,000 users of the app to win this car.

While no one knows what the exact contours of the next normal will look like, one thing is certain: consumers will return to the market. It can happen as quickly as quarantine did. This is why it is critical for us to keep marketing alive for the moment – showing our will to meet customers in any form or moment.

# KAMIQ SI TI

“Në ŠKODA Marketing Summit 2020, ŠKODA Albania konkuroi me këtë klip teksa konkurenca vjen nga e gjithë bota ku ŠKODA tregtohet.
Midis gjithë aplikimeve, “Ka miq si ti” arriti të nominohej si një nga 5 praktikat më të mira për vitin 2020 në kategorinë “Best launch campaign”.

“At ŠKODA Marketing Summit 2020, ŠKODA Albania competed with this clip among competition from all countries in the world whereby ŠKODA is traded. Among all the applications, “Friends like you exist”, succeeded in being nominated as one of the 5 best 2020 practices in the category “Best launch campaign”.



Kush ka miq si Elgit Doda, do ta kuptojë shumë mirë këngën e tij të fundit. Tashmë e dimë që dedikimet në projektet muzikore e “vjedhin’’ më lehtë zemrën e publikut, ndaj “Ka Miq Si Ti” ka bërë që të gjithë t’i kthejnë sytë nga kjo risi.

Po, e lexuat mirë, e cilësojmë si risi, pasi për herë të parë në tregun shqiptar, një kompani zgjedh muzikën për të depërtuar në shijet e atyre që kërkojnë modernen dhe komoden në një të vetme. Prezanton modelin e ri të ŠKODA-s, emri i së cilës duket sikur është krijuar enkas për gjuhën tonë. KAMIQ (që shqiptohet Kamik) u kthye menjëherë në frymëzim dhe ide origjinale për të prezantuar këtë model përmes një kënge.

Protagonistët e klipit janë vetë Elgiti dhe ŠKODA, të cilët si dy miq shumë të ngushtë me njëri-tjetrin, përshkojnë të pandarë rrugë të ndryshme të Shqipërisë. Ky koncept nuk vjen më kot, pasi KAMIQ në gjuhën origjinale do të thotë “diçka që përshtatet në mënyrë perfekte”, njësoj si modeli i ri i ŠKODA-s, që i shkon aq shumë (në këtë rast) Elgitit. Partneritete të tilla do të vazhdojnë, për të sjellë një frymë unike në tregun vendas.

Por nuk mbaron gjithçka këtu. Në ŠKODA Marketing Summit 2020, ŠKODA Albania konkuroi me këtë klip teksa konkurenca vjen nga e gjithë bota ku ŠKODA tregtohet. Midis gjithë aplikimeve, “Ka miq si ti” arriti të nominohej si një nga 5 praktikat më të mira për vitin 2020 në kategorinë “Best launch campaign”.

Tashmë, e keni ju në dorë të keni miq të pa ndashëm në përditshmërinë tuaj. Siç thotë edhe Elgiti: “për çdo ditë e për çdo natë”, me KAMIQ do të ndiheni “shumë me fat”!

Those having a friend like Elgit Doda, will best understand his latest song. We already know that “dedications” through music projects “steal” the heart of the public much easily. This is why “Friends like you exist” has made everyone turn their eyes to this innovation.

Yes, you read it well: we consider it a novelty, because, for the first time in the Albanian market, a company chooses music to penetrate the tastes of those looking for the modern and the comfortable, all in one. It introduces the new ŠKODA model, whose name seems to have been created exclusively for our language. KAMIQ (pronounced Kamik), immediately turned to inspiration and to the original idea of introducing this model through a song.

The clip stars Elgiti and ŠKODA, which, as two very close friends, cross different roads of Albania. This concept is not in vain as KAMIQ, which, in the original language means “something that fits perfectly”, just like the new ŠKODA model, suits (in this case) Elgit. Such partnerships shall continue bringing a unique spirit to the domestic market.

This is not all. At ŠKODA Marketing Summit 2020, ŠKODA Albania competed with this clip among competition from all countries in the world whereby ŠKODA is traded. Among all the applications, “Friends like you exist”, succeeded in being nominated as one of the 5 best 2020 practices in the category “Best launch campaign”.

Now, it is up to you to acquire inseparable friends in your daily life. As Elgit says: “every day and every night”, with KAMIQ you will feel “alive”!

# Zbulohet “misteri” i makinave të kamufluara që qarkullonin në Shqipëri

# The “mystery” of camouflaged cars circulating in Albania is revealed

Në rrugët e Shqipërisë gjatë muajit korrik kanë qarkulluar dy makina me veshje të kamufluar, të cilat kanë tërhequr vëmendjen e të gjithë atyre që i kanë parë. Cilës markë i përkisnin dhe mbi të gjitha, kush ishte misioni i tyre sekret?

E gjitha kjo ka qenë pjesë e fushatës për të sjellë pranë shqiptarëve surprizën e verës, modelin e ri të ŠKODA Octavia. Prezantimi i këtij modeli erdhi tërësisht ndryshe nga ajo që keni parë çdo vit, me një strategji që e bëri ŠKODA-n e maskuar të jetë kryefjala e të apasionuarve pas makinave në çdo qytet. Gjatë gjithë korrikut kjo makinë lëvizi në rrugët kryesore të vendit, me formën dhe ngjyrën e veçantë të kamuflazhit, duke bërë që të gjithë të debatonin mbi modelin dhe markën e saj.

Nuk mundën ta zbulonin se çfarë ishin as pjesëmarrësit në test drive-t që u zhvilluan, brandimi total i makinave nga kompania e kishte bërë këtë sfidë tepër të vështirë. Megjithatë, përshtypjet e tyre e kishin një të përbashkët, vlerësimin maksimal të performancës së automjeteve. Ndërkohë, të pakët në numër ishin ata që dhanë përgjigjen e saktë në rrjetet sociale të Drive Channel për pyetjen: “Cilës marke i përket kjo makinë misterioze?”, duke hamendësuar për “Audi” të llojeve të ndryshme, KIA e madje dhe Tesla.

Kështu, misioni u përmbush me sukses! Erdhi momenti kur njerëzit donin të dinin patjetër se çfarë fshihej poshtë kamuflazhit dhe tani më në fund e kanë një përgjigje.

Modeli i ri i ikonës Octavia vjen krejt ndryshe nga modelet e mëparshme të ŠKODA-s. Me një design të ri modern, me më shumë elegancë dhe duke përfaqësuar teknologjinë e fundit në automobilizëm, ŠKODA Octavia premton shumë për shoferët shqiptarë.

During July, two disguised cars circulated around the streets of Albania, attracting all those whose eyes they caught. What is that brand and, most of all, what was their secret mission?

All of this was part of the campaign to introduce Albanians to a summer surprise: the new model of ŠKODA Octavia. The launch of this new model came completely differently from the previous years’, with a strategy that made the disguised ŠKODA cars the headline of car enthusiasts in every city. Throughout July, they navigated the main roads of the country, with the special shape and colour of the camouflage’s, causing everyone to debate over its model and brand.

Not even the participants in the test drives were able to figure out the whole thing; the total cars’ branding by the company had made this challenge extremely difficult. However, their impressions had one thing in common: the maximum rating of vehicle performance. Meanwhile, fewer were the ones who gave the correct answer on the social networks of Drive Channel as far as the question “What brand does this mysterious car belong to?”, was concerned.

The mission was thus successfully completed! The moment came when people definitely wanted to know what was hidden under the camouflage and now, they finally have an answer.

The new Octavia icon model comes in quite different from previous ŠKODA models. With a new modern design, with more elegance and, representing the latest car technology, ŠKODA Octavia promises a lot for Albanian drivers.

# 15 VJET NË PORSCHE ALBANIA

## *My 15 years at Porsche Albania!*

Nëse flasim për sukseset, vështirësitë, sfidat, risitë dhe historinë e rritjes së kompanisë gjatë këtyre 15 viteve, të gjitha kanë një emërues të përbashkët: njerëzit! Dhe këtë artikull po ja kushtojmë kolegëve të cilët vazhdojnë të japin kontributin e tyre prej 15 vitesh në kompani. Si e mbajnë mend ata fillimin e rrugëtimit në Porsche, si janë rritur dhe çfarë suksesesh janë gdhendur në rrugëtimin e tyre drejt 15 vjetorit. Janë 6 kolegë që marrin pjesë në këtë mini intervistë dhe ndajnë me ne një pjesë të historisë së tyre.

- **E mban mend ditën e parë të punës tek Porsche? Si ka qenë ajo?**

**Bledar Kozma** – 5 gusht 2005 – Menaxher i markës ŠKODA

Në fakt unë do doja të përmendja datën 30 gusht, ditën e parë të hapjes së sallonit të makinave për klientët, ditë e cila u pagëzua me shitjen e parë - një SEAT Altea.

**Arven Flamuraj** – 1 shtator 2005 – Mjeshtër Servisi

Une sapo isha larguar nga një tjetër kompani tregëtimi automjetesh dhe në ditën e parë të punës më kujtohet që jam suprizuar kur kam takuar ish-kolegun nga puna paraardhëse. Ne nuk e dinim që ishim larguar të dy për të ardhur tek Porsche.

**Engjell Mehmetaj** – 1 shtator 2005 – Menaxher i departamentit të Pjesëve të Këmbimit

Po, më kujtohet dita e parë, kur gjatë prezantimit takoj kolegët e rinj, mes tyre ishte edhe një fytyrë e njohur për mua, Arveni. Ne kishim punuar së bashku dhe me sa duket do të vazhdonim edhe për 15 vite të tjera.

- **Si ka ndryshuar puna jote në këto 15 vite?**

**Bledar Kozma**

Kam nisur pranë markës SEAT në vitin 2005 si asistent shitjeje, më pas kam mbuluar Volkswagen Makina Tregtare për 7 vite, dhe sot jam Brand Manaxher i ŠKODA prej vitit 2014. Pra jam po në të njëjtin profesion, por me më shumë eksperiencë dhe më shumë përgjegjësi ndaj ekipit tim.

**Ilirjan Milla** – 12 shtator 2005 - Asistent Logjistike

Përveç ndryshimit të punës në volum, detyra dhe përgjegjësi, për mua puna pranë Porsche Albania-s ka ndikuar edhe në rritjen time personale. Kur sot shoh ndryshimin nga 15 vite më parë, jam krenar për rrugën që kam bërë.

**Arven Flamuraj**

Para 15 vitesh ishte fillimi i një pune shumë të madhe, me shumë përgjegjësi dhe me shumë mund dhe falë kësaj jemi sot servisi lider në Shqipëri.

- **Cila ka qenë arritja/suksesi më i madh i yti në Porsche?**

**Ramis Aliaj** – 1 shtator 2005 – Motorrist

Arritja që kam dëshirë të përmend gjithmonë, ka qenë zgjidhja e problemit që kishte një prej makinave në servisin tonë. Ishte një makinë Audi A8, V12 për të cilin nuk po arrinim të gjenim zgjidhje. Falë punës në skuadër, informacionit që kolegët nga fabrika ofruan, si edhe falë eksperiencës personale, arrita të gjej zgjidhje dhe të riparoj automjetin.

**Engjell Mehmetaj**

Sukses për mua është çdo ditë realizimi i detyrave, ndjekja e projekteve dhe përmbushja e objektivave. Çdo hap që hedhim në departament është pjesë e suksesit dhe punës tonë.

- **Çfarë të pëlqen më shumë tek profesioni që ke?**

**Ervis Vogli** – 15 tetor 2005 – Përgjegjës për repartin e Bojës

Profesioni që kam, kërkon impenjim të lartë, me duhet të kem durim, vëmendje dhe përkushtim të madh për të arritur rezultatet e duhura. Puna që unë bëj më jep kënaqësi të madhe kur fitoj besimin e klientëve dhe dorëzoj automjetin si një "nuse e re" që shkon tek bashkëshorti.

**Ramis Aliaj**

Unë kam 20 vite eksperiencë si mekanik/motorist dhe ajo çfarë më bën të vij me kënaqësi në punë është zgjidhja e problemeve. Më pëlqen angazhimi, kujdesi, kontrolli dhe gjetja e zgjidhjes! Është kënaqësi t'i rikthesh makinën klientit në gjendje perfekte pune dhe të dëgjosh zhurmën e motorrit kur niset sërish.

- **Një histori që do doje të ndaje për 15 vjetorin e Porsche Albania-s?**

**Bledar Kozma**

Ne jemi një ekip shitje sa dinamik aq edhe i qëndrueshëm. Për mua është për t'u përmendur se si në momente të ndrysme të historisë së POAL, të gjithë kemi patur mundësinë të jemi kolegë të të njëjtës markë. Kolegët e mi, sot janë në markat e Volkswagen-it dhe Audit. Kjo e bën më natyrale bashkëpunimin mes nesh dhe të jep kënaqësi të jesh pjesë e të njëjtit ekip.

**Ervis Vogli**

Histori? Po të gjithë më njohin si Visi i Porsche-s dhe më pelqen ky emërtim përkatësie. Çfarë mund të them më shumë se kaq.

**Ilirjan Milla**

Më kujtohet dhjetori i vitit 2005, kur zhvilluam darkën e parë të fundvitit me kolegët e Porsche-s dhe nuk kemi qenë më shumë se 12 persona. Sot kur numeroj, kam 15 vite që jam pjesë e aktiviteteve dhe eventeve të kompanisë, dhe çdo vit jemi rritur si staf, ku sot për mua është kënaqësi të kem 73 kolegë për të kremtuar së bashku.

Në këto 15 vite të shkuara dhe në shumë të tjerë që do të vijnë, vëmendja do të jetë gjithmone tek njerëzit. Sepse njerezit kanë rëndësi! Kontributi, dëshira dhe bashkëpunimi janë elementët që e bëjnë rrugëtimin tonë të suksesshëm dhe dinamik.

Successes, difficulties, challenges, innovations and growth of the company during these 15 years, bear a common denominator: people! We are dedicating this article to colleagues who continue providing their contribution within the company for 15 years now. What do they remember from their beginnings at Porsche, how they matured and what success stories were carved into their journey towards this 15th anniversary?
There are 6 colleagues who participated in this mini-interview and shared part of their stories with us.

- **Memories from the first day of work at Porsche?**

**Bledar Kozma** – 5 August 2005 – ŠKODA Brand Manager

I would like to mention the date August 30th, the first day of opening the car showroom to customers, the day which was baptized with the first sale - a SEAT Altea.

**Arven Flamuraj** – 1 September 2005 – Service Master

I had just left another car dealership and on the first day of work, I remember being surprised as I met my former colleague from the previous job. We had no idea we had both left to join Porsche.

**Engjell Mehmetaj** – 1 September 2005 – Spare Parts Division Manager

Yes, I remember the first day. During the introduction, I met new colleagues and, among them, a familiar face: Arven. We had worked together and would continue for another 15 years.

- **Changes in your job the last 15 years?**

**Bledar Kozma**

I started with SEAT in 2005 as a sales assistant, then I covered Volkswagen Commercial Vehicles for 7 years, and since 2014, I am the Brand Manager at ŠKODA. Thus, I hold the same job profession, but now more experienced and more accountable toward my team.

**Ilirjan Milla** – 12 September 2005 – Logistics Assistant

Besides the changes in the work volume, tasks and responsibilities, working with Porsche Albania has also affected my personal growth. When I see the changes compared to 15 years ago to today, I am proud of the path I have taken.

**Arven Flamuraj**

15 years ago, it was the beginning of a great job, with a lot of responsibilities and a lot of efforts and, thanks to all this, today we are the leading service provider in Albania.

- **Your greatest achievement/success with Porsche?**

**Ramis Aliaj** – 1 September 2005 – Engine Mechanic

The achievement I always like to mention, has solved the isse with one of the cars in our workshop. It was an Audi A8, V12 car for which we could not find a solution. Thanks to the teamwork, information provided by colleagues from the factory and, my personal experience, I was able to find solutions and repair the vehicle.

**Engjell Mehmetaj** – Success to me is daily fulfilling my tasks, following on projects and meeting objectives. Every step we take in our division, is adding up to the success of our job.

- **The highlight of your job?**

**Ervis Vogli** – 15 October 2005 – Responsible for the Paint Division

My job requires high commitment: I have to be patient and pay attention and great dedication to achieve the proper results. Gaining the trust of your clients and handing over the vehicle as a "new bride" to her husband, inundates me with great pleasure.

**Ramis Aliaj**

It is 20 years now working as an engine mechanic and what makes me happy to come to work is solving problems. I love commitment, care, control and finding solutions! It is a pleasure to return the car to the customer in perfect working conditions and hearing the noise of the gears restarting.

- **A story you would like to share for the 15th anniversary of Porsche Albania?**

**Bledar Kozma**
We are a dynamic and stable sales team. To me it is worth mentioning how, at different moments in the history of POAL, we have all had the opportunity to be colleagues of the same brand. My colleagues today work for Volkswagen and Audi. This makes the cooperation between us more natural and gives us the pleasure of being part of the same team.

**Ervis Vogli**

A story? Everybody knows me as Visi from Porsche and I like the feeling of this connection. What more should I add?!

**Ilirjan Milla**

I remember December 2005 when we had our first year-end dinner with Porsche colleagues. We were no more than 12 people by then. Today, after 15 years with the company, with every activity and event, I have the pleasure to witness how we have grown by, counting 73 colleagues happy to celebrate together.

In these past 15 years and in many more to come, our key word shall remain: the people. Because people matter! Efforts, wish and cooperation remain the core elements making our journey successful and dynamic.

# ID.3

Të gjithë mund të japim një kontribut sado të madh apo të vogël në të mirën e planetit tonë!

We can all make a contribution, no matter how big or small it is, for the good of our planet!

Çdo vit e më shumë shtohen pyetjet mbi mjedisin, teknologjinë, hapësirën, mundësitë ekonomike dhe përgjigjet ndaj tyre mbeten skica të papërfunduara të së nesërmes. Volkswagen ka përmbledhur këto skica dhe i bëri realitet në mjetin elektrik të quajtur Volkswagen ID-3!

Volkswagen ID.3 u prezantua në shtator 2019 për herë të parë në Frankfurt Motor Show. Për shkak të situates së krijuar këtë vit, dorëzimet e para u shtynë për pak kohë për të filluar me Gjermaninë si shtetin e parë që mori në duar një ID.3 që prej muajit shtator.

ID.3 është makina e cila pak nga pak po revolucionarizon makinat elektrike dhe po i jep ngjyra tregut, me sa duket njësoj si paardhësit e saj Beetle dhe Golf. Ajo është një nga aktoret më të forta kur vjen puna tek makinat elektrike me një çmim ekonomik. Me një autonomi prej maksimalisht 540km, ajo është e aftë të kryejë pak nga pak të gjitha detyrat që kryen një makinë me djegie të brendshme. E thënë ndyrshe, me të mund të udhëtosh për shumë kilometra pa u shqetësuar nesë do mundësh a jo të mbërrish në destinacion, dhe ta karikosh përsëri për vetëm 25 minuta nga 2% në 60% për vetëm 25 minuta.

Rrugëtimi dhe elementët shtesë të këtij zhvillimi revolucionar transporti u shpalosën në eventin e organizuar nga Porsche Albania në profilet në Facebook dhe Instagram.

ID.3 është "sportive si një Golf, e madhe si një Passat, e lehtë për t'u komanduar si një UP! dhe e shpejtë si një Golf GTI" ashtu si edhe shprehet edhe Blendi Salaj dhe Armand Saliu në prezantimin e makinës.

Natyrshëm mund të lindi pyetja: "Sa ekonomike është kjo makinë?". Duke iu referuar çmimit aktual të energjisë elektrike për përdoruesit shtëpiak, 100 kilometra me ID.3 kushtojnë mesatarisht vetëm 150 lekë të reja.

